




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL



RAPORT TREMUJOR
(prill – qershor 2024)

PËR AKTIVITETET DHE REKOMANDIMET E KOORDINATORIT
KOMBËTAR PËR LUFTIMIN E KRIMIT EKONOMIK

Prishtinë, gusht 2024

1. HYRJE – Mandati i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik

Pozita e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik është krijuar në bazë të një udhëzimi administrativ të lëshuar nga kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) me 27 dhjetor 2013. Personi i emëruar për atë pozitë ka kompetenca dhe përgjegjësi për detyrat në vijim:

1. Koordinimin e aktiviteteve për rritje të vetëdijesimit të të gjitha agjencioneve të përfaqësuara nga nënshkruesit e këtij memorandumi, përmes mediave publike dhe mënyrave tjera, për rreziqet që shoqërohen me dështim dhe benefitet e suksesit të luftimit të krimeve që gjenerojnë dobi pasurore;
2. Mbikëqyrjen e krijimit dhe implementimit të planeve të veprimit, të dizajnuara për të arritur dhe për të mirëmbajtur përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë;
3. Koordinimin e reagimit kombëtar ndaj kërkesave të organizatave ndërkombëtare për zhvillim të ekzaminimeve ose vlerësimeve kundër pastrimit të parasë;
4. Mbikëqyrjen e planifikimit dhe implementimit të programeve të trajnimit të përfshira në mandatin e Institutit kundër Krimit Ekonomik (IKE);
5. Identifikimin e mundësive për përmirësim, praktika më të mira dhe procedura operuese që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e programit dhe komunikimin e kësaj informate tek autoritetet e përshtatshme;
6. Grumbullimin dhe analizimin e informatave në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e entiteteve të involvuara në luftimin e krimeve që gjenerojnë dobi pasurore dhe raportimin e këtyre informatave tek autoritetet e përshtatshme;
7. Sigurimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për arritjen e objektivave të strategjive kombëtare për luftimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe ekonomisë joformale;
8. Rekomandimin e modifikimeve në strategji kombëtare ose legjislacion që do të përmirësonte përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë ose rritjen e efikasitetit apo efektivitetit të programit,
9. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë punën e të gjitha institucioneve relevante në R. e Kosovës lidhur me procesimin e rasteve që hyjnë në kuadër të kësaj rregulloreje dhe memorandumit të bashkëpunimit;
10. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë dhe do të përcjellë procedimin e rasteve nga institucioni në institucion;
11. Koordinatori mund të propozojë udhëzime për institucionet në fjalë se si të përmirësojnë nivelin e performancës dhe raportimit.
12. Koordinatori Kombëtar ka rol të rëndësishëm në dokumentin e aprovuar nga KPK mbi “Procedurat Standarde të Veprimit për përzgjedhjen e shënjestrave të krimeve të rënda dhe bashkëpunimi ndërinstitutional”;

13. Koordinator Kombëtar po ashtu ka rol edhe në dokumentin tjetër strategjik të aprovuar nga Qeveria e R. së Kosovës “Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018”.

Prokurori Shqipdon Fazliu, është caktuar nga KPK-ja për këtë pozitë. Ky raport do të bëjë të ditura aktivitetet e tij dhe të entiteteve të involvuara në tri shtyllat e programit të tij: parandalimi dhe detektimi, trajnimi dhe luftimi i krimit ekonomik.

2. ANALIZA&SUKSESET

Periudha e dytë e vitit 2024, prill – qershor, sjellë tri raste të raportuara me konfiskim përfundimtar. Është pozitiv fakti se paraqiten tri raste në një periudhë raportuese, mirëpo, poashtu duhet të nënvizohet fakti se bëhet fjalë për raste të vogla, meqenëse vlera e të tri rasteve me konfiskim, arrin vetëm në shumën prej 15,826.97 €. Ndërsa, në anën tjetër, kjo periudhë raportese e gjen vendin me një shifër të mirë të sekuestrimeve, respektivisht në shumën prej 975,426.46 €.

Nga këto tri raste të raportuara me konfiskim, dy raste vijnë nga PTH e Prizrenit, ndërsa një rast vjen nga PTH e Gjakovës. Në tri të rastet bëhet fjalë për konfiskim të nga një automjeti për secilin rast, si dhe para në një rast (plus një automjet).

Një veçori tjetër e konfiskimeve është fakti se duket se frytet e trajnimeve dhe takimeve të shpeshta në disa aspekte kanë filluar të sjellin rezultate, sepse konfiskimi automatik sipas nenit 276 ka filluar të zbatohet.

Tek rasti i PTH në Prizren ka pasur marrëveshje të fajësisë, por që veçantia e rastit ka të bëjë me faktin se mes tjerash, marrëveshja e fajësisë adreson edhe çështjen e konfiskimit, sipas nenit 230.7 të KPP-së dhe paraqet shembull shumë pozitiv të aplikimit të drejtë të dispozitave ligjore. Përpos përfitimeve të shumta që ka marrëveshja e fajësisë, adresimi i dobisë pasurore dhe mjetit të kryerjes së veprës penale, nënkupton më shumë kohë efektive për secilin prokuror, që individualisht të përkushtohet edhe në vet iniciativë në ndjekjen e krimeve më të rënda dhe nënkupton edhe shkarkim të gjykatave civile në trajtimin eventual të dobisë pasurore nga palët e dëmtuara dhe mbi të gjitha dhe me e rëndësishmja, adreson dëmin e shkaktuar nga pala e dëmtuar (nëse do të kishte palë të dëmtuar), duke marrë në konsideratë palën e dëmtuar, pikërisht sikur e kërkon vet KPP, në nenin 63. Qasja e tillë rritë imazhin e prokurorisë.

RASTET E KONFISKIMIT:

1. Rasti i parë evidentohet nën shifrat PP.II.nr.1432/2020, nga PTH e Gjakovës, Departamenti i Përgjithshëm, kërkesë e datës 18.06.2024, për shkak të veprës penale, falsifikimi i dokumenteve, nga neni 390.1 të KPRK-së (prokurorja e rastit – Dëshire Jusaj).

Në këtë rast nuk ka aktakuzë sepse bëhet fjalë për kërkesë për konfiskim të sendit që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, sipas nenit 276 të KPP-së.

Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, dega në Rahovec, P.nr.334/2020, i datës 01.07.2024.

Me këtë rast, gjykata ka vendosur që të konfiskoj automjetin e tipit Golf 2 dhe është urdhëruar AAPSK që të bëj shitjen e veturës në fjalë.

2. Rasti i dytë evidentohet nën shifrat PP.II.nr.1033/2020, nga PTH e Gjakovës, Departamenti i Përgjithshëm, kërkesë e datës 21.06.2024, për shkak të veprës penale, falsifikimi i dokumenteve, nga neni 390.1 të KPRK-së (prokurori i rastit – Kaastriot Memaj).

Në këtë rast nuk ka aktakuzë sepse bëhet fjalë për kërkesë për konfiskim të sendit që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, sipas nenit 276 të KPP-së.

Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, dega në Rahovec, P.nr.264/2020, i datës 01.07.2024.

Me këtë rast, gjykata ka vendosur që të konfiskoj automjetin e tipit Golf 2 dhe është urdhëruar AAPSK që të bëj shitjen e veturës në fjalë.

3. Rasti i tretë evidentohet nën shifrat PP.Lnr.8/24, aktakuzë e ngritur me dt. 07.05.2024, kundër të pandehurit E.M., për shkak të veprës penale: blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së (prokurori i rastit Petrit Kryeziu).

Në gjykatë rasti evidentohet nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.33/2024, i datës 17.05.2024 dhe numri i dokumentit: 05700535.

Me këtë rast, marrëveshja e fajësisë, në bazë të neneve 267.5, 235.1 nëparagrafi 1.9, lidhur me nenet 269, 270 dhe 276, ka përcaktuar konfiskimin e:

1. Veturës Seat Ibiza,
 2. Para të gatshme në shumën prej 1,100.00 €.
- Ajo që mund të veçojmë si pozitive gjatë kësaj periudhe tremujore është fakti se konfiskimet, ngrirjet dhe sekuestrimet kanë ndodhur për vepra të ndryshme penale, duke përfshirë vepra penale: Blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge; blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale; detyrim; falsifikim i dokumentit; falsifikim i parasë; hyrje në sistemet kompjuterike; kontrabandim me mallra; legalizim i përmbajtjes së rreme; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve; ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit; organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm; pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar; prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve; shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore; tregti e ndaluar; vjedhje pylli; vjedhje e rëndë; vrasje e rëndë në tentativë, vrasje e rëndë.

Më pas është edhe një fakt tjetër pozitiv që tregohet përmes faktit se 32 prokurorë janë përfshirë në 62 raste me sekuestrim apo ngrirje të pasurisë dhe në 3 raste me konfiskim.

-Trendi i zgjidhjes së rasteve të krimeve ekonomike në raport me ato të pranuar gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, është negativ. Të dhënat statistikore dëshmojnë se këtë tremujor janë pranuar gjithsej 67 raste të reja me 85 persona, ndërsa që janë zgjidhur 59 raste me 85 persona. Edhe më saktë, duke përdorur përqindjen, del se prokuroritë kanë zgjidhur 88.05% të rasteve të pranuar dhe 100% të rasteve me persona gjatë TM2 të vitit 2024.

-Më tutje, përderisa jemi ende te kjo çështje, është interesante të shihet se nga totali prej 85 rasteve të zgjidhura me persona në TM2, prokuroritë themelore dhe PSRK, së bashku, kanë vendosur të ngrisin aktakuza kundër 56 personave, apo në 65%, ndërsa kanë vendosur të pushojnë hetimet kundër 20 personave apo në 24% të tyre, si dhe kanë hedhur kallëzimet penale kundër 9 personave, apo në 11% të tyre.

- Te vepra penale e shpëlarjes së parave në TM2 të vitit 2024, kemi pasur 0 kallëzime penale të reja të pranuar kundër 0 personave, ndërsa që janë zgjidhur 0 raste me 0 persona. Pra, sikur që vërehet, PSRK as nuk ka pranuar e as nuk ka zgjidhur ndonjë rast gjatë kësaj periudhe tremujore.

-Ndërsa kur jemi te vendimet e gjykatave paraqitet një situatë pozitive, ngase kemi 27 vendime nga ana e gjykatës. Nga numri prej 27 personave, gjykatat kanë marrë aktgjykime fajësuese kundër 25 personave, në 0 raste është hedhur aktakuza para shqyrtimit gjyqësor, në 2 raste të akuzuarit janë liruar nga aktakuzat dhe në 0 raste është refuzuar aktakuza. Pra, nga totali prej 27 vendimeve për persona, në 92.59% të tyre gjykatat kanë shpallur personat fajtor sipas aktakuzave, në 0% të rasteve janë hedhur aktakuzat para shqyrtimit gjyqësor, në 7.40% të rasteve të akuzuarit janë liruar nga akuzat dhe në 0% është refuzuar aktakuza.

-Tek rastet e evidentuara si INFORMATA apo PPN-të, në TM2 të vitit 2024, janë pranuar 31 raste kundër 31 personave, ndërsa janë zgjidhur 44 raste kundër 247 personave.

3. KONSTATIMET

Periudha që përfshin tremujorin e dytë të vitit 2024, paraqet një tablo relativisht pozitive. Kjo, ngase janë raportuar tri raste me konfiskim përfundimtar, mirëpo me shifra të ulëta të konfiskimit.

Sukses të veçantë paraqet rasti me konfiskim nga PTH e Prizrenit, ngase përfshin një mënyrë pune që inkurajohet të përfshihet nga sa më shumë prokurorë dhe në sa më shumë raste.

Një gjë tjetër pozitive është e dhëna se më në fund edhe PSRK ka inicuar raste sipas LKZK-së. Pavarësisht faktit se kanë kaluar mbi 6 vite që nga hyrja në fuqi e këtij ligji, megjithatë, është me rëndësi se edhe PSRK ka inicuar raste sipas LKZK-së dhe mbetet të shihet rrjedha e këtyre rasteve.

Shembull i ngjashëm pozitiv, sikur në paragrafin më lart, është incimi i një rasti sipas LKZK, nga prokurorja e PSRK-së, që sërish si në rastin më lart, merr në konsideratë edhe interesin e palës së dëmtuar dhe paraqet rast tipik kur prokurori e ka parasysh tërësinë e rastit dhe e zgjidh rastin plotësisht.

Në anën tjetër, ka sfida që ende nuk janë tejkaluar. Bile disa janë rikthyer, edhe pse është menduar se Kosova më nuk kishte apo ishte menduar se kishte tejkaluar sfidat në fjalë. Të tilla janë shitja e asetëve, zbatimi i LKZK-së dhe shpëlarja e parave përmes aktivitetit kriminal.

4. LIGJI MBI KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT

Gjatë këtij tremujori, mund të raportohet si aspekt pozitiv fakti se më në fund edhe PSRK ka iniciuar dy raste me LKZK.

Rastet në proces e sipër sipas LKZK-së, janë si në vijim:

1. PTH Peja: PP/I nr. 250/22;
2. PTH Peja: PP/I nr. 1927/19;
3. PTH Peja: PP/I nr. 589/21;
4. PTH Peja: PP/I nr. 230/21;
5. PTH Peja: PP.I.nr.121/21, e dt. 23.08.2022. Në rastin PP.I.nr.121/2021, për rastin që ka të bëjë me veprën penale të fajdesë nga neni 331 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së, si dhe veprës penale: pengimi i personit zyrtar nga neni 401 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, tashmë Gjykata Themelore e Pejës ka marrë Urdhër Kufizues Përfundimtar, e evidentuar nën shifrat PN.nr.7/2023, e dt. 15.04.2024;
6. PSRK:PPS.nr. 44/2023, e dt. 27.06.2024. PSRK në këtë rast ka paraqitur kërkesë për Urdhër Kufizues Përfundimtar dhe Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti Special, nën shifrat PNDP.nr.6/2024, i dt. 12.07.2024, ka aprovuar kërkesën e PSRK-së dhe ka lëshuar Urdhrin Kufizues Përfundimtar, për një shtëpi familjare të të pandehurit të dënuar vite më parë për shpëlarje të parave. Raste të tilla si ky nga ana e PSRK-së do të kontribuojnë në të ardhmen në ngritjen e imazhit të prokurorisë, ngase përpos dënimit të të pandehurit, prokuroria ka marrë në konsideratë edhe interesin e palës së dëmtuar, pikërisht sikur e parashohin dispozitat ligjore dhe paraqet rast tipik ku prokurori bën një punë të duhur duke zbatuar drejt dispozitat ligjore.
7. PSRK: PPS.nr.88/2021, e dt. 18.04.2024. PSRK në këtë rast ka paraqitur kërkesë për Urdhër Kufizues Përfundimtar dhe Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti Special, nën shifrat PPS.nr.47/2021, i dt. 15.05.2024, ka aprovuar kërkesën e PSRK-së dhe ka lëshuar Urdhrin Kufizues Përfundimtar, për 16 parcela tokësore, një objekt residential dhe para të gatshme prej 144,000.00 €, si dhe një aset tjetër. Ndaj të pandehurit në këtë rast janë ngritur aktakuza për marrje ryshfeti, mashtrim me subvencione, mashtrim etj.

8. PTH Prizreni: PP.II.nr.1214-14/21, aktakuza është ngritur me datë 11.05.2023 dhe gjykata ende nuk ka caktuar shqyrtimin fillestar.

5. SHITJA E ASETEVE

- Për shitjen e aseteve, tashmë sa vite, kemi tërhequr vëmendjen e të gjithëve se nuk është vepruar në pajtim me dispozitat ligjore, duke bërë që depoja e AAPSK-së të stërngarkohet dhe të arrij në kufijtë maksimal, ashtu që brenda një kohe të shkurtër, nëse nuk bëhet shitje aseteve (automjeteve), depoja më nuk do të jetë në gjendje të pranoj automjete tjera. Natyrisht, kjo nuk është arsyeja kryesore por është një ndër arsyet përse duhet të veprohet pa vonesë të mëtejme.
- Duke pasur parasysh se shumë veprime tjera nuk kanë rezultuar me sukses, ne kemi organizuar një vizitë ne depon e AAPSK-së, ku kemi ftuar KPK-në, KGJK-në dhe partnerët ndërkombëtar, që të shihet edhe vizualisht gjendja ne depo. Vizita është organizuar me dt.17.07.2024 dhe ftesës sonë i janë përgjigjur vetëm disa anëtarë të KPK-së dhe 2 anëtarë të KGJK-së.
- Pas kësaj vizite, ne kemi organizuar edhe një vizitë tjetër, të ngjashme, por kësaj here kemi ftuar të gjithë koordinatorët e konfiskimit dhe kryeprokurorët (kryeprokurorët nga PTH Prishtina dhe Gjakova i janë përgjigjur ftesës).
- Në takimin e radhës me koordinatorët, jemi pajtuar, me sugjerimin e tyre, që në fund të tetorit të vitit 2024, të bëhen kërkesat për shitje.
- Në fillim të nëntorit e tutje, KKLKE, nëse vëren mos përgjigje në dakordimin e arritur për kërkesat për shitje të aseteve, do ti drejtohet U.D të Kryeprokurorit të Shtetit dhe vet KPK-së, që të iniciohen procedurat disiplinore ndaj prokurorëve të rasteve dhe kryeprokurorëve të aryre prokurorive për mos veprim sipas dispozitave ligjore.
- Përkujtojmë disa nga bazat ligjore për të vepruar në lidhje me shitjen e aseteve:
- Me datë 17.05.2017, Kryesuesit e KPK-së dhe KGJK-së si dhe Kryeprokurori i Shtetit kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi i quajtur, **APLIKIMI NGA PROKURORËT DHE VENDOSJA NGA ANA E GJYKATAVE PËR SHITJEN E ASETEVE, DHËNIES NË SHFRYTËZIM APO SHKATËRRIMIT** dhe që si qëllim kryesor ka që asetet e grumbulluara nëpër depot e AAPSK-së

stacioneve të ndryshme të policisë, prokurorive apo gjykatave, qoftë të shitën, të kalojnë në shfrytëzim të institucioneve të ndryshme apo edhe të shkatërrohen. Zbatimi i këtij MM ka qenë i ulët.

- Në maj 2024, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, ka nxjerrë Udhëzimin e Thjeshtësuar për Konfiskimin në Kosovë, ku në faqe 4, 5, 8, 23 flitet për nevojën për të vepruar në pajtim me ligjin, respektivisht shitjen e aseteve të sekuestruara. Ky Udhëzues është hartuar me ndihmën e partnerëve ndërkombëtar.
- Furnizimi i të gjitha prokurorive madje edhe me format e shkresave për të lehtësuar punë e prokurorëve dhe për të shkurtuar kohën në dispozicion që i duhet një prokurori për të hartuar kërkesat në fjalë;
- Shpërndarja tek të gjitha prokuroritë dhe gjykatat si dhe tek KPK dhe KGJK e rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtar rreth nevojës për një gjë të tillë (Fred Newton e David Mattan);
- Propozimin për tu konsideruar nga Kryeprokurori i Shtetit (eksperti Fred Newton rreth nevojës së shitjes së aseteve);
- Organizmi i disa vizitave të drejtpërdrejta në depon e AAPSK-së në mënyrë që të ngritet vetëdijësimi i zbatuesve të ligjit rreth çështjes në fjalë, përmes shikimit me sytë e tyre të situatës reale në depo;
- Direktiva 42/14 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian (neni 32);
- Udhëzimin e Kryeprokurorit të Shtetit të dt. 14.01.2014;
- Vet dispozitat ligjore në nenin 262.5, 262.6, 262.7 të KPP-së.

RAPORT TREMUJOR

Prill – qershor 2024

6. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Legjislacioni:

- Takime në kuadër të grupit punues për projektligjin PPP/LFT;
- Rishikimi, plotësimi dhe miratimi i rregullores për PPP/LFT të BQK-së;
- Miratimi i rregullores mbi informacionet që duhet të shoqërojnë transferet e fondeve.

Operacionet:

Banka Qendrore e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer dy (2) ekzaminime në fushën PPP/LFT në institucionet financiare si në vijim:

1. Ekzaminimi në institucionin financiar Ibas sh.a.;
2. Ekzaminimi në institucionin financiar Finser shpk.

Bashkëpunimi dhe trajnimet:

- Takime të grupit punues ACT të VKRr;
- Takime tjera me institucionet në kuadër të përgjegjësive të DPPP;
- Trajnim "Train the Trainer" mbi Pastrimin e Parave përmes Tregtisë (TBML) në Ohër, organizuar nga GIZ.

7. NJËSIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

Sipas mandatit të vet ligjor misioni i Njesisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NJIF-K) është të udhëheqë përpjekjet e Qeverisë për përmirësimin e parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar. Funksionimi i duhur i sistemit si tërësi, përmes bashkëpunimit të ngushtë institucional dhe aktiviteteve të Njesisë për Inteligjencë Financiare është objektiva kryesore e NJIF-K.

Në kuadër të ngritjes së efektivitetit lidhur me prioritetin strategjik, "Zhvillimi dhe përfundimi i dokumentit të Politikave dhe Koordinimi vendor për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (PPP/LFT-në)", përkatësisht fuqizimin e vlerësimit të rrezikut, menaxhimit të rrezikut dhe kornizës strategjike, NJIF-K dhe MFPT kanë inicuar Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të PP/FT. Ky vlerësim i rrezikut është duke u koordinuar nga NJIF-K dhe mbështetet nga grupi punues i përbërë nga KPK, Prokuroria e Shtetit, autoritetet e zbatimit të ligjit, autoritetet mbikqyrëse etj.

Në këtë periudhë raportuese, është përfunduar edhe Vlerësimi i Rrezikut Sektorial në Sektorin Bankar në vend.

Në kuadër të masave për forcimin e legjislacionit Kombëtar për PPP/LFT dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore (legjislacionit sekondar) për të qenë në harmoni me Direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, Grupi Punues ka mbajtur takimet dhe punëtoritë me akterët kryesor në vend në fushën e PPP/LFT.

NJIF-K është bashkë-nënshkruese e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të institucioneve dhe autoriteteve ligj-zbatuese me qëllim të funksionalizimit të Zyrës për Rikthimin e Aseteve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, NJIF-K së bashku me agjencionet tjera kanë marrë pjesë në disa vizita studimore në Itali, Finlandë, Luksemburg.

Në kuadër të promovimit të parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit/përhapjes dhe përfundimi i masave parandaluese me subjektet raportuese, NJIF-K së bashku me partnerët vendor dhe ndërkombëtar ka organizuar trajnime dhe punëtori për zyret e këmbimin e valutave, punëtori lidhur me Prezantimin e Metodologjisë së Këshillit të Evropës lidhur me Vlerësimin e Rrezikut për Pastrimin e Parave

dhe Financimin e Terrorizmit (VKR PP/FT), seminar trajnimi zbatimi sanksioneve financiare të shënjestuara sipas Rezolutave 1267 dhe 1373.

Në kuadër të Programit "Kundër Financimit të Terrorizmit", të mbështetur nga UNODC dhe OSBE për zyrtarët e Kosovës, janë certifikuar 8 zyrtarë për kursin "Trajner i Trajnerëve" nga agjencionet e ndryshme në vend përfshirë prokurorë, gjyqtar, hetues policor, zyrtar të NJIF-K etj.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur një sërë takimesh të grupit punues për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2024-2028.

Një sërë trajnimesh, punëtorish janë mbajtur nga zyrtarët e NJIF-K, ku ndër më kryesoret janë paraqitur si në vijim:

- Regional Anti-Corruption and Illicit Finance Roadmap Conference;
- Vizite studimore ne kuader te Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar, Tiranë, Shqipëri,
- Punëtori për Pronësinë Përfituese,
- Punëtori për Analiza Strategjike, Poloni,
- Trajnim për hetime financiare,
- Punëtori për Vlerësim të rreziqeve sektoriale, Lituani

Gjatë gjysmës së vitit 2024, NJIF-K ka pranuar gjithsej 383 raporte të transaksioneve/aktivitetit të dyshimtë. Në kuadër të bashkëpunimit me agjencionet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet tjera vendore, mbi bazën e kërkesave për informata, janë shkëmbyer 82 raporte të inteligjencës financiare.

Ka përmirësim të ndjeshëm të trajtimit të informatave kthyesë për NJIF-K bazuar në shpërndarjet e saj për hetime të mëtutjeshme. Ky progres veçohet nga Policia e Kosovës dhe ATK. Përderisa ka progres edhe nga disa prokurorë të PSRK në trajtimin e informatave kthyesë.

Si pjesë e forcimit të bashkëpunimit me NJIF homologe të huaj, me Egmont, dhe ngritja e bashkëpunimit me vendet e rajonit, NJIF-K ka marrë pjesë në takimin e grupeve punuese dhe regjionale të Egmont Group të mbajtur nga 29 Janar deri me 02 Shkurt 2024 në Maltë. Po ashtu, NJIF-K ka marrë pjesë në Takimin e 30-të Plenar të Egmont Group të mbajtur në Paris, France, nga data 2 deri 7 Qershor 2024. Gjatë vitit 2024, NJIF-K ka nënshkruar dy (2) MoU me njësitë homologe nga Tanzania dhe Izraeli.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me homologët e huaj, NJIF-K ka shkëmbyer gjithsej 31 raporte të inteligjencës financiare.

8. POLICIA E KOSOVËS

Paraqitja tabelore e trajnimeve të realizuara për periudhën **01.04.2024 deri me 30.06.2024**, nga Policia e Kosovës:

Raport 3 Mujo Prill Maj Qershor 2024				
Nr	Trajnime të organizuara nga DT	Organizator	Nr.trajnimeve	Nr. Pjesmarresve
1.	Trajnim Hetimi Financiar dhe Rikuperimi i Aseteve	Projektin UNDP/SAEK	1	4
2.	Trajnim Hetimet Financiare	GIZI	1	4
3.	Trajnim Krimet ekonomiko - financiare (jakat e bardha) dhe Valutat Virtuale	ICITAP & FBI	1	23
4.	Trajnime për trajnerë mbi hetimet financiare	OSBE	1	3

9. STATISTIKAT E NGRIRJEVE, SEKUESTRIMEVE DHE KONFISKIMEVE

Ngrirjet, sekuestrimet, dhe konfiskimet për tremujorin e dytë për vitin 2024

Sekuestrim:

Gjatë periudhës raportuese të tremujorit të dytë (prill-qershor) për vitin 2024, janë sekuestruar si në vijim:

- 51 automjete.....384,540.02 €
- Para kesh124,799.20 €
- Gurëthyes, Separacion, Kamion, Eskavator.....379,000.00 €
- Të tjera (artikuj ushqimor, duhan, cigare, kafshë, mjete piroteknike, motoçikletë, pajisje teknologjike, pije alkoolike dhe jo-alkoolike, stoli), etj.....87,087.24 €.

Konfiskim:

- Para.....1,100.00 €
- 3 Automjete.....14,726.94 €

Sekuestrime janë: 975,426.46 €

Konfiskime janë: 15,826.94 €

Totali i konfiskimit, sekuestrimit: 991,253.40 €

3 raste me LKZK-në, 2 nga PSRK 1.

1. **PPS.nr. 44/2013 Merita Bina Rugova**
2. **PPS.nr. 88/21 Rafet Halimi.**

10. SEKUESTRIMET PËR TREMUJORIN E II-të TË VITIT 2024

Nr. Rendor	Nr. i Prokurorisë	Vepra penale	Përshkrimi i pasurisë	Prokuroria	Data
1.	PP/l.nr.75/2023	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Prizren	17.04.2024
2.	PP/l.nr.85/2024	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Para	P.Th.Prizren	06.06.2024
3.	PPN/l.nr.86/23	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Automjet Para	P.Th.Prizren	10.06.2024
4.	PP/II.nr.2459-5/22	Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së	Para	P.Th.Prizren	04.03.2024
5.	PP.nr.619/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	07.05.2024
6.	PP/II.620/24	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Cigare	P.Th.Mitrovicë	12.04.2024
7.	PP/II.nr.621/24	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Automjet Pije alkoolike	P.Th.Mitrovicë	15.04.2024
8.	PP/II.774/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	03.05.2024
9.	PP/l.nr.53/2024	Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve neni 268 par.1 lidhur me 31 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	20.05.2024
10.	PP/II.nr.403/24	Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	10.05.2024
11.	PP/II.nr.388/24	Shmangie nga pagesa e tarifave te detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së	Automjet, Mjete piroteknike	P.Th.Mitrovicë	12.04.2024
12.	PP/II.nr.998/24	Shmangie nga pagesa e tarifave te detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së	Artikuj ushqimor	P.Th.Mitrovicë	19.06.2024
13.	PP/II.995/24	Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	14.06.2024
14.	PP/II.nr.765/24	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Pije alkoolike dhe jo- alkoolike	P.Th.Mitrovicë	10.05.2024
15.	PP/II.nr.947/24	Shmangie nga pagesa e tarifave te detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së	Cigare	P.Th.Mitrovicë	04.06.2024
16.	PP/II.798/24	Vjedhje e rëndë neni 315 par 1 i KPRK-së	Automjet Stoli	P.Th.Mitrovicë	20.05.2024
17.	PP/II.nr.831/24	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Cigare	P.Th.Mitrovicë	15.05.2024
18.	PP/II.nr.370/24	Vjedhje e rëndë neni 315 par 1 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Mitrovicë	03.04.2024
19.	PP/II.550/24	Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së	Para Pajisje teknologjike	P.Th.Mitrovicë	12.04.2024
20.	PP/II.nr.668/24	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Pije alkoolike	P.Th.Mitrovicë	22.04.2024
21.	PP/II.nr.667/24	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Duhan	P.Th.Mitrovicë	23.04.2024

22.	PP/II.nr.830/24	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Automjet Artikuj ushqimor	P.Th.Mitrovicë	15.05.2024
23.	PP/II.nr.484/24	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Mjete piroteknike	P.Th.Mitrovicë	16.05.2024
24.	PPN/II.nr.231/2024	Vjedhje e pyllit neni 349 të KPRK-së	Traktor	P.Th.Gjakovë	18.06.2024
25.	PPN/II.nr.220/24	Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Gjakovë	14.06.2024
26.	PPN/II.nr.198/2024	Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit neni 338 par 1 te KPRK-se	1 gurethyes, 2 seperacione, 1 eskavator	P.Th.Gjakovë	04.06.2024
27.	PPN/II.nr.199/2024	Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit neni 338 par 1 te KPRK-se	1 separacion, 1 gurethyes	P.Th.Gjakovë	04.06.2024
28.	PPN/II.nr.118/2024	Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Gjakovë	04.04.2024
29.	PP/I.nr.33/2024	Vrasje e rëndë në tentativë neni 173 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Gjakovë	18.04.2024
30.	PPN/II.nr.266/24	Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së	Automjet	P.Th.Pejë	21.05.2024
31.	PP/II.nr.593/2024	Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit neni 338 par 1 te KPRK-se	Automjet	P.Th.Pejë	22.04.2024
32.	PPN/II.nr.971/24	Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit neni 338 par 1 te KPRK-se	Kamion Eskavator Separacion	P.Th.Pejë	
33.	PPN/II.nr.357/2024	Vjedhje e pyllit neni 349 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Pejë	14.06.2024
34.	PP/I.nr.30/24	Vrasje e rëndë neni 172 par 1 pika 1.8 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Pejë	12.06.2024
35.	PP/II.nr.573/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Duhan	P.Th.Ferizaj	29.04.2024
36.	PP/II.nr.479/24	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Karrike	P.Th.Ferizaj	30.04.2024
37.	PP/II.nr.572/24	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Cigare	P.Th.Ferizaj	17.04.2024
38.	PP/II.nr.437/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Gjedhë	P.Th.Gjilan	30.04.2024
39.	PP/II.nr.712/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Gjilan	24.03.2024
40.	PP/II.nr.599/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet Cigare/Duhan	P.Th.Gjilan	22.05.2024
41.	PP/II.nr.529/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Artikuj ushqimor	P.Th.Gjilan	08.05.2024
42.	PPN/II.nr.209/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Gjilan	23.04.2024
43.	PPN/II.nr.310/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Mallra të ndryshme	P.Th.Gjilan	15.04.2024
44.	PPN/II.nr.238/2024	Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së	Cigare/Duhan	P.Th.Gjilan	18.06.2024
45.	PP/II.nr.660/2024	Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së	Duhan	P.Th.Gjilan	07.05.2024
					17.05.2024

46.	PP/I.nr.11/24	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së, Rrëmbim neni 191 par 2 nën par 2.1 lidhur me par 1 të KPRK-së	Para Pajisje teknologjike	P.Th.Prishtinë	24.05.2024
47.	PP/I.nr.62/24	Vrasje e rëndë në tentativë neni 173 par 1 nënpar 1.5 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së	Automjet	P.Th.Prishtinë	04.04.2024
48.	PP/I.nr.73/24	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së	Automjet Para	P.Th.Prishtinë	17.04.2024
